



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ibadete Guri	27.01.2026	04.02.2026	2026/0031

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.01.2026, OE “Avokatura Istrefi” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0031, kundër njoftimit mbi vendim të AK-s për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Sejdiu & Qerkini ” SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit” me nr. të prokurimit: "616-25-8826-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur ,lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi;

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi;

Neni 28 Specifikimet Teknike;

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës;

Neni 64 Dëshmitë e kërkesave;

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale;

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Dhe dispozita tjera të LPP-së.

Rregullorja nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 26.15 – Grupi i Operatorëve Ekonomik

I. Sa i përket "Deklaratës nën Betim":

AK konsideron se ne nuk e kemi plotësuar si duhet "Deklaratën nën Betim" dhe konform nenit 10.1 të

Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik na eliminon automatikisht. Neni i sipërtheksuar i jep të drejtë AK-së të na eliminoj po qe se nuk kemi dorëzuar fare "Deklaratë nën Betim", mirëpo në rastin konkret të dy anëtarët e GOE, në mënyrë individuale kemi dorëzuar "Deklaratat nën Betim" dhe të njëjtat janë të plotësuara, të nënshkruara dhe të vulosura.

Të gjitha elementet identifikuese me të cilat vërtetohet se secili OE nga Grupi ynë ka bërë "Deklaratën nën Betim" janë të dallueshme, të identifikueshme dhe të pakontestueshme dhe si të tilla i përmbajnë të dhënat e sakta identifikuese për secilin OE, prandaj AK nuk ka pasur të drejtë të na eliminoj për këtë arsye ngase ligji dhe Udhëzuesi i jep të drejtë AK-së të eliminojë vetëm në rast të mungesës së këtij dokumenti, e në rastin ne i kemi dorëzuar ato.

Duke u nisur nga qëllimi thelbësor i "Deklaratës nën Betim" e që është "garantimi i përgjegjësisë ligjore" në rastin konkret ky element është përmbushur plotësisht si vijon:

I.1. Lideri i GOE "Avokatura Istrefi" Sh.P.K. pjesën tabelare ku theksohet "Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)" e ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, ndërsa në pjesën hyrëse lartë ku theksohet

"Unë i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar (lideri i Grupit) ka shënuar "Konzorciumin e OE "Avokatura Istrefi dhe Osmani", dhe kjo nuk nënkupton kurrfarë gabimi meqenëse kuptohet se lideri e përfaqëson tërë grupin, megjithatë në rastin konkret deklarata është plotësuar dhe nënshkruar nga OE "Avokatura Istrefi" Sh.P.K. siç shifet në plotësimin e bërë tabular dhe në emër individual siç obligohet me LPP e jo siç pretendon AK se ne e kemi nënshkruar deklaratën në emër të Grupit, pasi në rast të tillë nuk do të kishim dorëzuar edhe deklaratën e nënshkruar nga anëtari tjetër.

I.2. Anëtari i GOE "Avokat Jeton Osmani" B.I. "Deklaratën nën Betim" e ka plotësuar në tërësi, ndërsa në pjesën hyrëse nuk e ka përmendur emrin, mirëpo shënimet e sakta janë plotësuar në tabelë në mënyrë të duhur dhe këto janë shënimet thelbësore të cilat "Deklarata nën Betim" duhet ti përmbajë, pasi mbi bazën e këtyre informatave OE deklaroi se i përmbushë kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje, e që është edhe kusht themelor për aplikim.

Edhe praktika konsistente e OSHP-së ndalon eliminimin e OE për lëshime teknike që nuk cenojnë substancën e dokumentit, veçanërisht kur nuk ekziston rrezik për mashtrim apo keqinterpretim. Përkitazi me praktikën e OSHP-së për "Deklaratën nën Betim" ekzistojnë shumë vendime të OSHP-së për këtë çështje ndër tjerash edhe Vendimi OSHP 2025/0968 i dt. 18.12.2025.

PROVA 1 e bashkangjitur: Deklaratat e dorëzuara në aktivitetin e prokurimit të cilat AK i konsideron jo të rregullta.

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [Konzorciumin e OE: "Avokatura Istrefi dhe Osmari"] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	"AVOKATURA ISTREFI" SH.P.K.
Adresa e plotë:	RR. "BILL CLINTON" H. 69, KATI, NR. 1, PRISHTINË, 10000
I përfaqësuar nga:	
Emri	ARBËR ISTREFI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	17.10.2025
Vula	

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	AVOKAT JETON OSMANI B.I.
Adresa e plotë:	RR. "STOKHOLM" H. 5, NR. 38, OBJEKTI I TREGTISË
I përfaqësuar nga:	
Emri	JETON OSMANI
Pozita	PRONAR DHE AGJENT I REGJISTRUAR
Nënshkrimi	

II. Pretendimi se mungon nënshkrimi dhe vula në marrëveshjen e konzorciumit të përpiluar

nga

KRPP të dt. 11.11.2024

Ky pretendim është faktikisht i pavërtetë.

Marrëveshja standarde e aprovuar nga KRPP më 11.11.2024:

- Është e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy anëtarët e konzorciumit;

- Pjesa që AK e ka identifikuar si të paplotësuar i referohet shprehimisht situatës "shto sipas nevojës", pra rasteve kur grupi përbëhet nga më shumë se dy anëtarë. Meqenëse GOE "Avokatura Istrefi dhe Osmani" përbëhet vetëm nga dy operatorë ekonomik, kjo pjesë që i referohet AK nuk është relevante për aplikimin tone, ngase është e paraparë nëse GOE i ka tre e më tepër anëtarë.

AK ka vepruar në mënyrë selektive, duke mos paraqitur pjesën përkatëse të dokumentit që vërteton qartë nënshkrimin dhe vulosjen e rregullt.

PROVA 2: Aneksi 7 i plotësuar, i nënshkruar dhe i vulosur, së bashku me pjesën përkatëse "shto sipas nevojës".



Në vijim është edhe deklarata e nënshkruar dhe e vulosur se si është dorëzuar nga GOE, e jo siç ka konstatuar AK (në prova e emërtuar PROVA 3):

8. Ne të gjithë anëtarët e grupit pranojmë që: nëse një anëtar i grupit tërhiqet pas dorëzimit të tenderit (gjatë fazës së vlerësimit), Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me anëtarin e mbetur, nëse anëtarin i mbetur i plotëson kushtet e parapara në Dosje të Tenderit. Po ashtu ne pranojmë që në këtë rast ndaj anëtarit i cili tërhiqet nga grupi, Autoriteti Kontraktues të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider) "Avokatura Istrefi" Sh.P.K.

Emri Mbiemri Arbër Istrefi

Data/ Nënshkrimi/ Vula 17.10.2025



Anëtarët e tjerë të grupit:

Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar) Avokat Jeton Osmani B.L.

Emri Mbiemri Jeton Osmani

B28_Ng Dosje e Tenderit për Kontraktin Publikë Komizë – Sherbim Me Disa OE

26

Data/ Nënshkrimi/ Vula 17.10.2025

Shto sipas nevojës...

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar)

Data/Nënshkrimi / Vula



III. Pretendimi i AK-së lidhur me Marrëveshjen e dytë, Standardit të KRPP-së dhe nenin 65 të LPP-së:

AK deklaroi se ekzistojnë "kundërshtime" ndërmjet marrëveshjes së brendshme të GOE dhe marrëveshjes standarde të KRPP-së, pa specifikuar asnjë dispozitë konkrete, asnjë nen dhe asnjë mospërputhje reale ndërmjet këtyre dy marrëveshjeve të dorëzuara nga GOE, por në formë të përgjithësuar thekson se ka kundërshtime ndërmjet tyre dhe se marrëveshja e brendshme nuk i ka paraparë nenet që i kemi plotësuar në

Marrëveshjen e standardizuar nga KRPP.

Ne si GOE ankues, kemi plotësuar edhe marrëveshjen standard të KRPP-së dhe njëkohësisht konform nenit 26.15 të Rregullores 002/2024 kemi nënshkruar edhe një marrëveshje të brendshme shtesë për arsye ligjore dhe objektive, pasi marrëveshja standarde e KRPP-së nuk rregullon disa elemente thelbësore, si:

- Selia dhe komunikimi zyrtar i GOE;
- Modalitetet e pagesës;
- Administrimi i konzorciumit;
- Përgjegjësia për ruajtjen e dokumentacionit.

Këto elemente janë të kërkuara me LPP dhe legjislacioni sekondar dhe nuk bien në asnjë mënyrë ndesh me marrëveshjen standarde të KRPP-së, por e plotësojnë atë.

Sa i përket specifikimeve teknike të cilat qëllimisht nuk i kemi shënuar në marrëveshjen e brendshme, ato janë të përfshira dhe të deklaruara në Aneksin 7 të DT-së (Standardin e KRPP-së) andaj nuk ka qenë e nevojshme që të njëjtat specifikime të duplikohen në çdo marrëveshje të brendshme pasi të njëjtat parashihen dhe janë plotësuar në Aneksin 7 dhe kjo aspak nuk bie ndesh me njëra tjetrën, ashtu siç pretendon AK, e nga ana tjetër nuk përmend asnjë element se cili paragraf, në marrëveshjen e brendshme bie ndesh me Standardin e KRPP-së, të plotësuar në Aneksin 7.

Marrëveshja jonë e brendshme e emërtuar si: "Marrëveshja për themelimin e grupit" është në përputhje të plotë me nenin 26.15 të Rregullores nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e cila parasheh si vijon:

26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.

IV. Shkeljet e OE fitues me të cilat AK e shpallë të përgjegjshëm dhe e shpërblenë me kontratë:

Në "kriteret teknike dhe profesionale" të parapara me dosjen e tenderit, në pikën 9.1 dhe 9.2 paragrafi 2 ishte paraparë që OE të ketë të paktën pesë (5) avokat me licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe kjo të dëshmohet me marrëveshjet për angazhim të avokatëve.

OE fitues, në dokumentacionin e dorëzuar, kishte paraqitur pesë kontrata me avokat të ndryshëm për të përmbushur kushtin teknik dhe profesional, mirëpo njëra nga këto kontrata, gjegjësisht ajo me avokate Blinera Osmanin, është e datës 01 tetor 2021 me kohëzgjatje për 1 vit, e cila përfundon më datën 30 shtator 2022 (PROVA 4). Këto elemente gjinden në nenin 5 të kontratës "Afati", paragrafi 1 dhe 2 - citojmë:

1: "marrëveshja lidhet për një periudhë 1 vjeqare dhe nuk përtrihet automatikisht" dhe

2: "Marrëveshja hyn në fuqi më 1 tetor 2021 dhe skadon më 30 shtator 2022".

Ky dështim i OE fitues të paraqes kontratë të vlefshme me afat kur është shpallë dosja e tenderit, bie në kundërshtim me nenin 3.2 të Dosjes së Tenderit (3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin).

Në lidhje me këtë argument, ne si GOE e njoftojmë OSHP-në se ky argument nuk është theksuar në "Kërkesën për Rishqyrtim" të dorëzuar në AK, mirëpo është theksuar si ankesë plotësuese me anë të emailit të dorëzuar te zyrtarët e prokurimit në AK - Komuna e Prishtinës dhe kjo nuk është bërë për fajin tonë, pasi që konsiderojmë se AK qëllimisht e kishte publikuar Letrën standarde për tenderuesin e suksesshëm më datën 31 dhjetor 2025 (ora 15:45) duke ditur se ishte kohë festash për festën e vitit të ri dhe meqenëse afati i fundit i ushtrimit të mjetit juridik dhe kërkesës për qasje në dokumente mund të bëhej vetëm për një ditë që është dita e hënë (5 janar 2026), ne e kishim të pamundur që të presim ditën e fundit për të siguruar dokumentacionin me të cilin OE fitues kishte aplikuar dhe për të përpiluar "kërkesën për rishqyrtim", prandaj ne si GOE këtë mjet juridik e kemi dorëzuar ditën e dielë (4 janar 2026) dhe të nesërmen në ora 11:00 na është lejuar qasja në dokumentaicon dhe deri sa e kemi analizuar dhe kemi gjetur këtë mospërputhje (kontratën e punës me afat të skaduar), atëherë i kemi dërguar email shtesë Departamentit të Prokurimit dhe i kemi bashkangjitur provat përkatëse, mirëpo kjo nuk është trajtuar nga AK Komuna e Prishtinës, për këtë arsye konsiderojmë se OSHP do ta trajtojë edhe këtë argument dhe do të ketë parasysh edhe afatet dhe publikimin e njoftimeve nga AK Komuna e Prishtinës pikërisht ditëve kur janë pushimet dhe i vështirësohet OE të paisen me dokumente dhe të kenë çasje të barabartë në mundësinë e ushtrimit të mjeteve juridike, pa diskriminim dhe pa preference subjektive.

Kjo është kontrata faqe 1 dhe 4 e shkëputur e cila thekson afatin deri më 30 shtator 2022 me të cilën OE fitues është konsideruar i përgjegjshëm dhe është shpallë fitues.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të:

SEJDIU & QERKINI, SHPK

një shoqëri e avokatëve e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik të identifikimit 810905523, me seli në Lagja Veternik, EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 18, 10000 Prishtinë, Kosovë, dhe e përfaqësuar nga Dr. Artan Qerkini, Drejtor Menaxhues (tash e tutje **"S&Q"**),

dhe

BO Legal Consulting , SHPK

një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik të identifikimit 811591040, me seli në Lagja Veternik, EXDC3, Blloku 10, Kati 6, Nr. 17, 10000 Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga znj. Blinera Osmani, Drejtore Menaxhuese (tash e tutje **"Kompania"**).

Prishtinë, 1 tetor 2021

5. AFATI

- 5.1 Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 1 vjeçare, dhe nuk pëtrihet automatikisht.
- 5.2 Marrëveshja hyn në fuqi më 1 tetor 2021, dhe skadon më 30 Shtator 2022.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L- 42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net,	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administratimoret e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblym të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepr penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në faliment ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblym të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 1. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk është shpallur fajtor nga gjykata kompetente për kryerjen e një vepr penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në faliment ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblym të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.
it nën Kontratën Publike Komizë – Shërbim Me Disa OE	12
	kaluar nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepr penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është në faliment ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblym të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

2. Të jetë shoqëri e avokatëve konform nenit 27 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 04 L-193 për Avokatinë për së paku shtatë (7) vit me të paktën pesë (5) avokat me licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Të paktën njëri nga	2. Një kopje të vendimit nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Licencat për avokatët. Nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhim të avokatëve nga Shoqëria.		
it për Kontratën Publike Komizë – Shërbim Me Disa OE			
13			
avokatët duhet të ketë përvojë për më shumë se 10 vjet pas licencimit nga OAK.			
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	<table> <tr> <td data-bbox="354 1098 435 1518"> 11.1 </td><td data-bbox="435 1098 1239 1518"> a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. <i>Secili anëtar i Grupit të Operatoreve Ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike</i> f. <i>Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7</i> </td></tr> </table>	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. <i>Secili anëtar i Grupit të Operatoreve Ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike</i> f. <i>Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7</i>
11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. e. <i>Secili anëtar i Grupit të Operatoreve Ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike</i> f. <i>Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7</i>		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit i përberë nga Manush Gashi Kryesues, Albina Qesjtaj dhe Arben Kqira anëtarë, konstatojnë se për aktivitetin e Prokurimit me titull: "Sherbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit" me nr. Prokurimit: 616-25-8826-2-2-1, AK ka pranuar 2 (dy) oferta.

Oferta e GOE-ik: Avokatura Istrefi SH.P.K.; Avokat Jeton Osmani dhe Oferta e OE-ik: "SEJDIU & QERKINI" SH.P.K.

Sipas vendimit për formimin e komisionit të vlerësimit të datës 02.12.2025, komisioni i vlerësimit ka filluar punën e vlerësimit me datë 18.12.2025. Pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave komisioni ka konstatuar si vijim:

Oferta e GOE-ik: Avokatura Istrefi SH.P.K.; Avokat Jeton Osmani – Nuk i ka plotësuar kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për kontratë: Kërkesën e përshtatshmërisë Kërkesa: *Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L- 42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rks-gov.net>. Dëshmia: Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 të Dosjes së Tenderit. Anëtarët e grupit të Operatoreve Ekonomik me oferte kanë dorëzuar Deklaratat nën betim mirëpo jo sipas kërkesës. Lideri i Grupit (Avokatura Istrefi SH.P.K.) ka dorëzuar Deklaratën nën betim si ne vijim:*

Aneksi 2.

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [Konzorciumin e OE: "Avokatura Istrefi dhe Osmani"] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Lideri i Grupit ka dorëzuar Deklaratën nën betim në emër të grupit e jo siç kërkohet të dorëzohet veç e veç

11

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

Aneksi 2.

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- Anëtarit tjetër i konzorciumit ka dorëzuar Deklaratën nën betim pa e plotësuar si duhet deklaratën nën betim dhe konform RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK: Mungesa e plotësimit të deklaratës nën betim apo ekzistencës / Refuzo tenderin pa kërkuar sqarime shtese / Kusht administrativ.

Oferta e GOE-ik Avokatura Istrefi SH.P.K.; Avokat Jeton Osmani – Nuk kanë përmbushur edhe kërkesën tjetër të DT-se Aneksi 7 të DT-së. MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit konform deklarates të aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024. GOE-ik ka dorëzuar 2 deklarata për formimin e grupit. Deklarata për formim të grupit konform deklarates të aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024 nuk është plotësuar, nënshkruar dhe vulosur pjesa ku është përcaktuar Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i Autorizuar).

Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar) _____

Data/Nënshkrimi / Vula _____

Sipas RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK: Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës/ Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm / Kusht administrativ.

Deklarata e dyte e dorëzuar nga GOE-ik nuk i plotëson kërkesat e nenit 65 të LPP-se si dhe është në kundërshtim me MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit konform deklarates të aprovuar nga KRPP të datës 11.11.2024.

- GOE-ik nuk ka dorëzuar specifikimet teknike të cilat kanë qenë të bashkangjitura me dosjen e tenderit (Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - Sipas përshkrimit teknik - Parametres dhe skicave të projektit të bashkëngjitura në DT), andaj tenderi

12

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE **"Avokatura Istrefi" SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sherbimet e përfaqësimit të avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit"** me numër të prokurimit: **"616-25-8826-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

juaj është refuzuar duke u bazuar në UDHËZUESIN Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR
PLOTËSIM NDRYSHIMI E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ku thuhet:

"Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik"- AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzojë specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzojë specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar)

Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, Neni 28 i LPP-së

Komisioni i vlerësimit konstaton se oferta e GOE-ik **Avokatura Istrefi SH.P.K.**; Avokat **Jeton Osmani** – është e papërgjegjshme dhe eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Oferta e OE-ik: " SEJDIU & QERKINI " SH.P.K. – I ka plotësuar të gjitha kërkesat e DT-se dhe Njoftimit për kontratë. OE-ik me oferte ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuar si dëshmi sipas kërkesave në DT.OE-ik ka dorëzuar dëshmitë konform: Kërkesat e përshtatshmërisë: Përshtatshmëria profesionale, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Kapaciteti teknik dhe profesional.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - "Avokatura Istrefi" SH.P.K.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar në tërësi dhe me kujdes të gjitha pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik ankues në ankesën e tij. Për qëllime të qartësisë, koherencës dhe për të shmangur

përsëritjet e panevojshme, pretendimet ankimore në këtë raport paraqiten në formë të përmbledhur, duke ruajtur thelbin e secilit pretendim ashtu siç është ngritur nga ankuesi. Pas secilit pretendim të përmbledhur, jepet përgjigja përkatëse e ekspertit.

Pretendimi ankimor nr. 1 (i përmbledhur)

OE ankues kundërshton eliminimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues ka konstatuar në mënyrë të gabuar se “Deklarata nën Betim” nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, për shkak se në pjesën hyrëse të deklaratës, përkatësisht te formulimi “Unë i poshtë-nënshkruari”, është shënuar emri i konzorciumit dhe jo vetëm emri individual i Operatorit Ekonomik.

Sipas OE ankues, ky konstatim përbën **interpretim tepër formalist** të kërkesës, pasi që, pavarësisht mënyrës së formulimit në pjesën hyrëse të deklaratës, **identiteti i Operatorit Ekonomik deklarues është i qartë dhe i pakontestueshëm** nga përmbajtja e përgjithshme e dokumentit. Në veçanti, OE ankues thekson se:

- Në pjesën tabelare të “Identifikimit të Operatorit Ekonomik (OE)” janë të shënuara saktë të gjitha të dhënat identifikuese të OE-së përkatëse;
- Deklarata është e nënshkruar dhe e vulosur nga personi i autorizuar i OE-së;
- Secili anëtar i Grupit të Operatorëve Ekonomikë ka dorëzuar **Deklaratë nën Betim individuale**, duke përmbushur qëllimin thelbësor të këtij dokumenti, përkatësisht garantimin e përgjegjësisë ligjore për përmbajtjen e deklaratës.

OE ankues argumenton se përdorimi i emërimit të konzorciumit në pjesën hyrëse të deklaratës **nuk e cenon substancën e dokumentit**, nuk krijon paqartësi lidhur me subjektin deklarues dhe nuk përbën mungesë të dokumentit në kuptim të nenit 10.1 të Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Për rrjedhojë, sipas OE ankues, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë ligjore për eliminim, pasi që deklaratat janë dorëzuar, janë të plota dhe janë të vlefshme në aspektin përmbajtësor.

OE ankues, gjithashtu, i referohet praktikës konsistente të OSHP-së, sipas së cilës **lëshimet formale që nuk ndikojnë në përmbajtjen thelbësore të dokumentacionit dhe nuk krijojnë rrezik për mashtrim apo keqinterpretim**, nuk duhet të rezultojnë me eliminimin e Operatorit Ekonomik nga procedura e prokurimit.

Përgjigje në pretendimit ankimor nr. 1

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, dokumentacionit të lëndës dhe “Deklaratave nën Betim” të dorëzuara nga anëtarët e Grupit të Operatorëve Ekonomikë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është **i bazuar**.

Nga provat e administruara rezulton se për aktivitetin e prokurimit janë dorëzuar **dy “Deklarata nën Betim” të ndara**, respektivisht nga secili anëtar i GOE-së, të cilat janë të nënshkruara dhe, në rastin e OE-ve juridikë, të vulosura, si dhe përmbajnë të dhënat identifikuese të Operatorëve Ekonomikë përkatës.

Është e vërtetë se në pjesën hyrëse të deklaratës, përkatësisht te formulimi “Unë i poshtë-nënshkruari”, në njërin nga deklaratat është shënuar emërtimi i konzorciumit, mirëpo nga **përmbajtja e përgjithshme e dokumentit**, veçanërisht nga pjesa tabelare e “Identifikimit të Operatorit Ekonomik (OE)”, identiteti i OE-së deklaruese është i qartë, i saktë dhe i pakontestueshëm.

Eksperti shqyrtues vlerëson se ky konstatim përbën **lëshim formal**, i cili nuk ndikon në substancën e dokumentit, nuk cenon qëllimin e “Deklaratës nën Betim” – garantimin e përgjegjësisë ligjore të Operatorit Ekonomik – dhe nuk krijon rrezik për mashtrim apo keqinterpretim të informacionit të

deklaruar.

Në këtë kontekst, theksohet se neni 10.1 i Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik parasheh eliminimin e OE-së **vetëm në rast të mungesës së dokumentit**, ndërsa në rastin konkret dokumenti është dorëzuar dhe përmban elementet thelbësore të kërkuara.

Bazuar në sa më sipër dhe në praktikën konsistente të OSHP-së, sipas së cilës operatorët ekonomikë nuk duhet të eliminohen për lëshime formale që nuk cenojnë përmbajtjen thelbësore të dokumentacionit, **eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar .**

Pretendimi ankimor nr. 2 (I përmbledhur)

OE ankues kundërshton konstatimin e Autoritetit Kontraktues se Marrëveshja e Konzorciumit nuk është e nënshkruar dhe e vulosur në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke vlerësuar se ky konstatim është **i pasaktë dhe i pambështetur në gjendjen faktike të rastit.**

Sipas OE ankues, Marrëveshja standarde e Konzorciumit, e aprovuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) me datë 11.11.2024, është dorëzuar **e plotësuar, e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy anëtarët e Grupit të Operatorëve Ekonomikë**, përkatësisht nga lideri i GOE-së dhe nga anëtari tjetër i grupit.

OE ankues sqaron se pjesa e dokumentit të cilës i është referuar Autoriteti Kontraktues si e paplotësuar lidhet me rubrikën “**shto sipas nevojës**”, e cila, sipas natyrës dhe qëllimit të saj, aplikohet vetëm në rastet kur grupi përbëhet nga **më shumë se dy operatorë ekonomikë**. Duke qenë se GOE në rastin konkret përbëhet vetëm nga dy OE, kjo rubrikë nuk është relevante dhe mosplotësimi i saj nuk përbën mangësi materiale.

OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues, duke u fokusuar vetëm në këtë rubrikë dhe duke anashkaluar pjesët e tjera të dokumentit që vërtetojnë qartë nënshkrimin dhe vulosjen e rregullt të Marrëveshjes së Konzorciumit, ka vepruar në mënyrë **selektive dhe formale**, pa vlerësuar dokumentin në tërësinë e tij.

Në këtë kontekst, OE ankues thekson se Marrëveshja e Konzorciumit e dorëzuar përmbush kërkesat thelbësore të Dosjes së Tenderit dhe qëllimin për të cilin është kërkuar, dhe se eliminimi për këtë arsye përbën **formalizëm të tepruar**, i cili nuk ndikon në përmbajtjen thelbësore të dokumentit dhe nuk krijon paqartësi lidhur me marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të GOE-së.

Përgjigje në pretendimit ankimor nr. 2

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe dokumentacionit të lëndës, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues **nuk është i bazuar.**

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se **Deklarata/Marrëveshja e themelimit të Grupit të Operatorëve Ekonomikë nuk është plotësuar si duhet**, përkatësisht në rubrikën që i referohet **përfaqësuesit të autorizuar**, ku mungojnë të dhënat e kërkuara, përfshirë emrin, nënshkrimin dhe vulën.

Eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë rast **Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të drejtë**, kur ka konstatuar se dokumenti përkatës **nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit**, lidhur me deklarinimin dhe autorizimin e përfaqësuesit të secilit anëtar të grupit.

Rubrika “**shto sipas nevojës**” ka karakter teknik dhe shërben ekskluzivisht për rastet kur Grupi i Operatorëve Ekonomikë përbëhet nga më shumë se dy anëtarë, me qëllim të shtimit të anëtarëve të tjerë të grupit, dhe **nuk ka asnjë lidhje me autorizimin apo përfaqësimin e anëtarëve ekzistues të konzorciumit.**

Për rrjedhojë, pretendimi i OE ankues se mungesa e konstatuar nga AK-ja lidhet me këtë rubrikë **bazohet në një interpretim të shtrembëruar të përmbajtjes së dokumentit dhe nuk mbështetet në gjendjen faktike të administruar në këtë çështje.**

Duke qenë se dokumenti i dorëzuar nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhe se vlerësimi i AK-së është bërë mbi bazën e gjendjes reale të dokumentacionit, **eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar .**

Pretendimi ankimor nr. 3 (i përmbledhur)

Në këtë pretendim ankimor, OE ankues kundërshton arsyetimin e dhënë nga AK lidhur me pretendimin për kundërshtim ndërmjet marrëveshjes së brendshme të Grupit të Operatorëve Ekonomikë dhe Marrëveshjes standarde të KRPP-së, duke vlerësuar se ky kundërshtim është i pabazuar. Sipas OE ankues, marrëveshja e brendshme është hartuar në përputhje të plotë me nenin 26.15 të Rregullores nr. 002/2024 dhe shërben për rregullimin e çështjeve që Marrëveshja standarde e KRPP-së nuk i detajon, si: modalitetet e pagesës, administrimi i konzorciumit dhe përgjegjësia për dokumentacionin.

Specifikimet teknike të përfshira në marrëveshjen e brendshme janë në harmoni me Aneksin 7 të DT-së dhe nuk bien ndesh me standardin e KRPP-së, por e plotësojnë atë. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë kundërshtim real apo juridik ndërmjet dy marrëveshjeve, ndërsa pretendimi i AK-së mbështetet në një interpretim të gabuar të dispozitave përkatëse.

Përgjigje në pretendimit ankimor nr. 3

Pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar. Neni 26.15 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton detyrimin që, në rast pjesëmarrjeje si grup i operatorëve ekonomikë, të dorëzohet së bashku me ofertën Marrëveshja për themelimin e grupit, në formën standarde të miratuar nga KRPP, e cila duhet të përmbajë, ndër të tjera, autorizimin e qartë të partnerit udhëheqës për veprim në emër të grupit.

Autoriteti Kontraktues këtë kërkesë e ka përfshirë në Dosjen e Tenderit dhe ka bashkëngjitur formën standarde përkatëse. OE ankues e ka dorëzuar marrëveshjen me ofertën, mirëpo nuk e ka plotësuar pjesën që lidhet me përfaqësuesin e autorizuar të grupit, element ky thelbësor për përmbushjen e kërkesës ligjore.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka vepruar drejt kur ka konstatuar mospërmbushjen e kërkesës sipas nenit 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik. Bazuar në nenin 72 të LPP-së dhe në Udhëzuesin për Prokurimin Publik, pika 10.1, mungesa e deklaratës së nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizimin e partnerit udhëheqës përbën kusht administrativ dhe imponon refuzimin e tenderit pa kërkuar sqarime shtesë. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor refuzohet si i pabazuar.

Pretendimi Ankimor nr. 4 (i përmbledhur)

OE ankues kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpalljen përgjegjshëm dhe dhënien e kontratës OE fitues, duke vlerësuar se i njëjti nuk i ka përmbushur kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Konkretisht, OE fitues ka paraqitur kontrata bashkëpunimi me avokate, të cilat sipas përmbajtjes së tyre janë kontrata me afat të kufizuar dhe të skaduara më 30

shtator 2022, ndërsa kriteret e tenderit kërkonin dëshmi valide dhe aktive për periudhën përkatëse.

OE ankues thekson se këto kontrata nuk përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike sipas pikave përkatëse të Dosjes së Tenderit dhe bien ndesh me nenin 3.2 të DT-së, pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk është i përshtatshëm dhe nuk dëshmon përmbushjen e kapaciteteve profesionale në kohën e vlerësimit të ofertave. Për rrjedhojë, vlerësohet se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar të dokumentacionit dhe ka shkelur parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe nenin 6 të LPP-së, andaj kërkohet anulimi i vendimit të AK-së.

Përgjigje në pretendimit ankimor nr. 4

Pretendimi ankimor i OE ankues lidhur me përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale nga OE fitues.

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesën që operatori ekonomik të jetë shoqëri e avokatëve në përputhje me nenin 27 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, me së paku shtatë (7) vite përvojë dhe me të paktën pesë (5) avokatë të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, si dhe që, në rast të angazhimit të avokatëve shtesë, të dorëzohen marrëveshjet përkatëse të angazhimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues rezulton se, për qëllim të dëshmimit të kapaciteteve profesionale, janë dorëzuar gjithsej pesë (5) marrëveshje bashkëpunimi. Ndër këto, është paraqitur edhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet dy shoqërive të avokatëve, e përfaqësuar nga znj. Blinera Osmani. Megjithatë, nga përmbajtja e kësaj marrëveshjeje rezulton qartë se ajo ka qenë e vlefshme vetëm për periudhën 01.10.2021 deri më 30.09.2022, sipas pikës 5.1 të saj. Po ashtu, pika 5.4 e marrëveshjes përcakton shprehimisht se, në mungesë të përtrirjes në formë të shkruar, marrëveshja konsiderohet e përfunduar dhe se nuk parashikon asnjë përtrirje automatike.

Në ofertën e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për përtrirjen me shkrim të kësaj marrëveshjeje pas datës 30.09.2022. Për rrjedhojë, marrëveshja e bashkëpunimit e paraqitur nga ky OE nuk ka qenë valide as në kohën e ofertimit dhe nuk mund të konsiderohet si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Duke marrë parasysh sa më sipër, vlerësohet se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të pasaktë të dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues, në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe parimet e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. **Për rrjedhojë, pretendimi ankimor vlerësohet i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Nga sa u shtjellua më sipër, vlerësohet se në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar vetëm dy oferta, nga të cilat oferta e OE ankues është eliminuar me të drejtë nga AK-ja, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i përmbush kërkesat kualifikuese. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë ofertë e përgjegjshme andaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimi i AK-së dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"Avokatura Istrefi" SH.P.K.**

Ibadete Guri

